

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7830  
E martë, 9 korrik 2024  
Çmimi 0.50 €

ShBA-ja ia përsërit  
thirrjen Serbisë, kërkon  
drejtësi për vrasjen e  
vëllezërve Bytyqi



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ASOCIACIONI DHE NJOHJA 'DE-FACTO', BRUKSELI PRET IDETË E KOSOVËS DHE TË SERBISË SE SI TË ZBATOHET MARRËVESHJA BAZË



Bashkimi Evropian (BE) është në pritje të ideve të Kosovës dhe të Serbisë për zbatimin e marrëveshjes bazë për normalizimin e raporteve në

mes të dy shteteve. Deri më 18 korrik ka mbetur që Kosova dhe Serbia t'i dërgojnë komentet e tyre lidhur me planin për zbatimin e kësaj

marrëveshjeje. Në këtë kontekst, Kosova është duke e kërkuar njohjen de-facto, ndërsa Serbia Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe

**PRESIDENTJA OSMANI ME FTESË TË SEKRETARIT BLINKEN UDHËTON PËR NË SHBA** F.3



**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT KUFITAR KOSOVË - SHQIPËRI** F.5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### AKTUALE



**ZYRAPI THOTË SE PAS FORMIMIT TË QEVERISË SË PËRKOHSHME ASPEKTET USHTARAKE VIJUAN TË MBESIN PJESË E UÇK-së** F.3

**'S'KA AS ÇARÇAFË', KIMIOTERAPI NË SALLË TË IMPROVIZUAR TË HEMATOLOGJISË** F.4

**LANSOHET FUSHATA 'FESTO ME ZEMËR, JO ME ARMË'** F.7

**HAXHIU KUNDËRSHTON RAPORTIN E IKD-SË PËR VLERËSIMIN E PËRFORMANCËS SË ANËTARËVE TË KGJK-SË DHE KPK-së** F.7

### EKONOMI



**AUDITORI GJEN PARREGULLSI NË NJË TENDER TË KOSTT-it** F.8

**PUNËTORËT TEKNIKË TË KUVENDIT PARALAJMËROJNË GREVË NËSE NUK U RRIEN PAGAT** F.8

### SPORT



**SONTE GJYSMËFINALJA E PARË, SPANJA E FRANCA KËRKOJNË FINALEN** F.10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Franca përballet me krizë politike pas rezultatit të zgjedhjeve

PARIS, 8 KORRIK - Në Francë pritet të nisnin negociatat për formimin e qeverisë së re teksa vendi po përballet me një parlament "të varur" pas rritjes së papritur të bllokut të krahut të majtë në zgjedhjet e së dielës, që bllokojnë përpjekjen e ekstremistëve të djathtë të vijë në pushtet.

Fronti i Ri Popullor i krahut të majtë ka dalë fuqia dominuese në Asambledën Kombëtare pas zgjedhjeve të së dielës, por asnjë grup nuk ka fituar vetëm shumicën dhe ka mundësi që ky front të formojë një qeveri të pakicës apo ta synojë ndërtimin e një koalicioni më të gjerë.

Rezultatet e zgjedhjeve ishin një goditje e madhe për presidentin francez Emmanuel Macron, duke paralajmëruar një periudhë të paqëndrueshmërisë politike vetëm disa javë para se Parisi të jetë nikoqir i Lojërave Olimpikë.

Macroni ka përfunduar me një parlament jashtëzakonisht të fragmentuar, që pritet ta dobësojë rolin e Francës në Bashkimin

Evropian dhe më gjerë dhe do ta bëjë të vështirë për këdo që t'i shtyjë përpara agjendat e brendshme.

E majta ka fituar 182 ulëse, aleanca centriste e Macronit 168 dhe Tubimi Kombëtar i Marine Le Pen dhe aleatët 143, sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme të publikuara nga gazeta "Le Monde".

"Sipas logjikës së institucioneve tona, Emmanuel Macron duhet që zyrtarisht sot ta ftojë Frontin e Ri Popullor që të nominojë një person për kryeministër", ka thënë liderja e të Gjelbërve, Marine Tondelier, një prej shumë figurave të Frontit të Ri Popullor që shihet si kandidatë potenciale për këtë post. "A do ta bëjë ai këtë? Si gjithmonë, presidenti na befason. Le ta shohim", ka thënë ajo për Radio "RTL".

Kryeministri Gabriel Attal ka thënë se do ta dorëzojë dorëheqjen, por është e paqartë nëse dorëheqja do të pranohet menjëherë nga presidenti, duke pasur parasysh detyrën për formimin e një qeverie.



Attal ka thënë se ai është i gatshëm të qëndrojë si kryeministër në detyrë.

Partitë e Frontit të Ri Popullor ku bëjnë pjesë Partia Komuniste Franceze, Franca e Panënshtuar nga krahu i majtë, të Gjelbrit dhe Partia Socialiste janë takuar gjatë natës për bisedimet e para se si të veprojnë pas zgjedhjeve.

Udhëheqësi i "Franca e Panënshtuar", Jean-Luc

Melenchon, ka thënë se kryeministri i ri duhet të jetë nga Fronti i Ri Popullor. Megjithatë, ky bllok nuk ka lider dhe partitë që janë pjesë e këtij fronti janë thellësisht të ndara lidhur me atë se kush duhet të jetë kandidat për kryeministër.

Disa prej figurave centriste, përfshirë Edouard Philippe, ish-kryeministër gjatë udhëheqjes së Macronit, ka thënë se është i

gatshëm të punojë për një marrëveshje që të ketë një ekzekutiv të qëndrueshëm, por ka shtuar se nuk janë të gatshëm të punojnë me partinë e Melenchonit, që shumë nga centristët në Francë e shohin po aq ekstremiste sa Tubimi Kombëtar.

Rezultatet e partisë së Le Pen ishin shumë larg nga sondazhet e mëhershme që parashihnin një fitore të Tubimit Kombëtar.

Aleanca e majtë dhe ajo centriste bashkëpunuan pas raundit të parë të zgjedhjeve, duke tërhequr kandidatët – kur kishte gara në mes të tre kandidatëve – në mënyrë që t'i bashkonin forcat kundër Tubimit Kombëtar.

Le Pen, e cila me gjasë do të jetë kandidatja e partisë së saj për zgjedhjet presidenciale të vitit 2027, ka thënë pas zgjedhjeve se Tubimi Kombëtar ka shënuar fitore në krahasim me zgjedhjet paraprake, duke trasuar rrugën për të ardhmen. "Fitorja jonë thjesht është vonuar", ka thënë ajo.

## Bideni i vendosur: Do ta mposht Trumpin



UASHINGTON, 8 KORRIK - Presidenti amerikan Joe Biden u është drejtuar demokratëve të Kongresit në një letër të hënën, duke u thënë se nuk do të tërhiqet nga gara pavarësisht prej shqetësimeve në rritje për aftësinë e tij mendore dhe qëndrueshmërinë e fushatës së tij. "Dua që ju të dini se pavarësisht nga të gjitha spekulimet në shtyp dhe gjetkë, unë jam i vendosur për të qëndruar në këtë garë deri në fund dhe për ta mposhtur Donald Trump", inësthtë thënë në letërën e Bidenit.

Kongresi kthehet në Uashington të martën për herë të parë që nga debati i 27 qershorit në "CNN" që ka shkaktuar shqetësime mbi aftësinë e Bidenit për të siguruar një fitore për demokratët në nëntor dhe për të shërbyer katër vjet të

tjera në detyrë.

Në javën pas performancës së tij katastrofike të debatit, Bideni personalisht ka kontaktuar me afërsisht 20 demokratë të Dhomës së Përfaqësuesve, ka thënë një zyrtar i fushatës për "CNN", dhe ka folur me liderët e partisë duke përfshirë udhëheqësin e shumicës në Senat, Chuck Schumer, udhëheqësin e pakicës në Dhomën e Përfaqësuesve, Hakeem Jeffries dhe deputetët Nancy Pelosi dhe James Clyburn, me synimin për t'i siguruar ata se shqetësimet brenda partisë po dëgjohen.

Pelosi ka thënë se pyetjet rreth performancës katastrofike të Bidenit në debatin presidencial ishin "legjitime".

I pyetur për komentet e Pelosit,

Bideni ka thënë për "ABC News", "ishte një ngjarje e keqe. Asnjë indikacion për ndonjë gjendje të rëndë. Isha i raskapitur."

Në një telefonatë me demokratët e lartë të Dhomës së Përfaqësuesve të mbledhur të dielën nga Jeffries, një sërë ligjvënës shprehën shqetësimet e tyre gjatë një bisede që një ndihmës e përshkroi për "CNN" si "shumë brutale".

Këta ligjvënës, të cilët "CNN" ka raportuar se përfshijnë përfaqësuesit Jerry Nadler, Adam Smith, Mark Takano dhe Joe Morelle përfaqësojnë demokratët e rangut më të lartë në komisionet e Gjyqësorit, të Shërbimeve të Armatosura, të Çështjeve të Veteranëve dhe të Administratës së Dhomës së Përfaqësuesve.

## Orbani: Putini nuk do ta sulmonte një vend të NATO-s

BUDAPEST, 8 KORRIK - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, ka shprehur bindjen se është e pamundur që presidenti rus, Vladimir Putin, të sulmojë një vend të NATO-s. "Asnjë njeri serioz nuk mund të thotë për Rusinë se synon ta sulmojë NATO-n", ka thënë ai në një intervistë për gazetën gjermane "Bild".

Sulmi kundër NATO-s është krejtësisht i pamundur - jo vetëm për Rusinë, por për këdo në botë - pasi është komuniteti më i fuqishëm ushtarak, tha Orban.

Prej se ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, Putini ka bërë disa kërcënime - qoftë direkte, qoftë të tërthorta -

kundër NATO-s.

Orbani ka theksuar se të gjitha vendet e NATO-s qëndrojnë pas zotimit të tyre për sigurinë kolektive, që do të thotë se sulmi ndaj një aleati të NATO-s është sulm ndaj të gjithëve.

"Rusët kanë një histori dhe kulturë ndryshe. Ata e shohin ndryshe nga evropianët edhe lirinë edhe sovranitetin kombëtar", ka thënë Orban, i cili ka takuar Putinin javën e kaluar në Moskë. "Por, ata janë racionalë, janë hiper-racionalë", ka thënë ai.

Duke folur për zgjedhjet presidenciale në ShBA, që do të mbahen në nëntor, Orban ka thënë se beson se presidenti

aktual Joe Biden nuk do të rizgjidhet. Ai e ka lavdëruar kundërkandidatin republikan të Bidenit, Donald Trump. "Ai është një biznesmen, është një njeri i vetëkrijuar, ka qasje ndryshe për gjithçka. Dhe, unë mendoj se kjo është gjë e mirë për politikën botërore", tha Orban për gazetën gjermane. "Të mos harrojmë se ai është njeri i paqes", pohoi Orban, duke shtuar se Trumpi nuk ka nisur asnjë luftë të vetme gjatë katër vjetëve të tij në detyrë.

Orbani ka qenë i vetmi kryeministër i një vendi të Bashkimit Evropian që ka shprehur hapur mbështetjen e tij për Trumpin edhe para zgjedhjes së tij president në vitin 2016.



## Zyrapi thotë se pas formimit të Qeverisë së Përkohshme aspektet ushtarake vijuan të mbesin pjesë e UÇK-së

HAGË, 8 KORRIK - Dëshmitari Bislim Zyrapi gjatë dëshmisë së tij në Hagë ka pohuar se është ende i qëndrimit që pas krijimit të Qeverisë së Përkohshme, aspektet ushtarake kanë vijuar të mbesin pjesë e UÇK -së. Një gjë të tillë dëshmitari e kishte thënë edhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, të cilën e ka pohuar edhe të hënën në sallën e gjyqit duke iu përgjigjur pyetjeve të mbrojtjes së Thaçit, përmes avokatit Luka Mishetiç, raporton "Betimi për Drejtësi".

Po ashtu, ai ka pohuar se qëndron fakti ashtu siç e kishte thënë që kur Fatmir Limaj kaloi në Ministrinë e Mbrojtjes, nuk e kishte më në dorë komandën e policisë ushtarake, sepse kjo njësi vijoi të qëndronte nën urdhrat e UÇK-së.

Zyrapi ka pohuar se derisa është bartur në Qeverinë e Përkohshme, Sokol Dobruna i ka raportuar komandantit të përgjithshëm të UÇK-së, Agim Çekut.

"Po, derisa nuk është bartur në Qeverinë e Përkohshme", ka thënë Zyrapi.

Pas funksionit të tij në UÇK, dëshmitari ka thënë se ka shkuar të punonte si asistent në Ministrinë e Mbrojtjes e që më pas ka deklaruar se ky dikaster bënte pjesë në Qeverinë e



Përkohshme dhe jo në UÇK.

"Ashtu është", ka thënë dëshmitari, duke shtuar se nuk mund të emërohej në këtë pozitë nga komandanti i ri i UÇK-së, Agim Çeku, pasi Qeveria e Përkohshme nuk ishte në pushtetin e tij.

Në një përgjigje për ZPS-në se a bënte kontroll Qeveria e Përkohshme mbi UÇK-në,

dëshmitari ka thënë se me rregulla do të duhej të bëhej një gjë e tillë.

"Përgjigja juaj është kjo: Sipas rregullave kështu duhet të kishte qenë, por nuk e di se deri ku kanë arritur", ka thënë Luka Mishetiç duke e lexuar përgjigjen e dëshmitarit për ZPS-në.

Ndërsa në përgjigjen e tanishme, dëshmitari ka thënë se shumë

problem ka qenë që Shtabi i Përgjithshëm të ketë ndikim mbi njësitë e lëre më Qeveria e Përkohshme.

"Nuk është çështja vetëm e dyshimit se edhe mundësia nuk është lejuar që kanë mundur në atë kohë që Qeveria e Përkohshme të ketë një ndikim. Shumë problem ka qenë që Shtabi i Përgjithshëm të ketë

ndikim në njësitë e lëre më Qeveria e Përkohshme, e cila ishte vetëm në fillim të formimit për arsye të ofensivave të rrepta që ishin, lëvizjet e forcave të tona dhe normalisht mundësia e komunikimit në njësitë më poshtë nuk ka mundur të jenë as nga Shtabi, po as nuk ka mundur të ketë ndikim as Qeveria e Përkohshme në atë kohë pasi flasim për periudhën kohore prej prill-majit në atë drejtim. Faktikisht prill, kur unë kam qenë brenda", ka thënë Zyrapi.

Dëshmitari ka thënë se nuk është në dijeni për përbërjen e plotë të anëtarëve të Qeverisë së Përkohshme, por vetëm për një pjesë të tyre. Ai ka thënë se ishte në dijeni se në formacionin e saj kishte nga parti të ndryshme politike. "Nuk ishin me një vend. Ishin të shpërndarë në shumë vende, disa në Kosovë, disa në Shqipëri, disa jashtë. Po anëtarët e Qeverisë së Përkohshme në atë kohë, po foli për periudhën në prill, kanë qenë pak ata që kanë qenë brenda, grup shumë i vogël", ka thënë Zyrapi kur është pyetur se ku qëndronin anëtarët e Qeverisë së Përkohshme.

## Presidentja Osmani me ftesë të sekretarit Blinken udhëton për në ShBA

PRISHTINË, 8 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, me ftesë të sekretarit të Shtetit të ShBA-së, Antony Blinken, ka udhëtuar për në Uashington D.C., për të marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i cili mbahet në kuadër të Samitit të NATO-s, në 75-vjetorin e themelimit të kësaj organizate ushtarake.

Duke vlerësuar ftesën e sekretarit Blinken, presidentja Osmani ka theksuar se përfshirja e Kosovës në aktivitete të tilla është e një rëndësie të veçantë, meqë është hera e parë që Kosova përfshihet në ngjarje në kuadër të samitit të NATO-s.

Kjo mundëson krijimin e partneriteteve të reja në rrugëtimin e Kosovës drejt



anëtarësimit në NATO.

Përfshirja e Kosovës në aktivitetin e organizuar nga sekretari Blinken dedikuar Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë është tregues i

fuqishëm i rolit në rritje që po luan Kosova në avancimin e kësaj agjende në nivel global dhe përkushtimit të saj ndaj parimeve dhe vlerave të mbështetura nga

NATO-ja.

Gjatë qëndrimit në Uashington D. C., presidentja Osmani do të zhvillojë edhe aktivitete e takime të tjera ku do të diskutohet forcimi

i bashkëpunimit me qëllim të kontributit për paqe dhe siguri në rajonin tonë e më gjerë.

Kujtojmë se Zyra e Presidentes është përzgjedhur në mesin e tre partnerëve globalë nga Zyra e sekretarit Blinken për ta themeluar Qendrën Rajonale të Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Marrëveshja për themelimin e kësaj Qendre është nënshkruar nga presidentja Osmani dhe Zyra e sekretarit Blinken në prill 2024, gjatë Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Samiti i NATO-s në Uashington D. C. shërben si një platformë për shtetet anëtare dhe shtetet partnere që të bashkëpunojnë në çështjet urgjente të sigurisë globale dhe ta riafirmojnë përkushtimin e tyre për një të ardhme më të sigurt.

## ShBA-ja ia përsërit thirrjen Serbisë, kërkon drejtësi për vrasjen e vëllezërve Bytyqi

UASHINGTON, 8 KORRIK - Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), Matthew Miller, ka ripërsëritur thirrjen e ShBA-së për drejtësi për vrasjen e vëllezërve Bytyqi të cilin ishin me shtetësi amerikane.

Në rrjetet sociale Miller është shprehur të hënën se autorët e atij akti brutal janë të lirë.

Zëdhënësi i DASH-it i ka kërkuar qeverisë serbe ta vazhdojë hulumtimin të marrë përgjegjësi për vrasjen e tre vëllezërve.

"25 vjet më parë shtetasit amerikanë Ylli, Agron dhe Mehmet Bytyqi u vranë në paraburgimin e policisë serbe. Sot autorët e këtij akti brutal mbeten të lirë. Ne i

bëjmë thirrje Serbisë sërish ta përfundojë hetimin dhe t'i sjellë para drejtësisë përgjegjësit për vdekjen e tyre", ka shkruar ai në platformën "X".

Agron, Ylli dhe Mehmet Bytyqi, shtetas amerikanë, kishin lënë ëndrrën amerikane për t'iu bashkuar Ushtrisë Çlirimtare.





## Asociacioni dhe njohja 'de-facto', Brukseli pret idetë e Kosovës dhe të Serbisë se si të zbatohet marrëveshja bazë

Bashkimi Evropian (BE) është në pritje të ideve të Kosovës dhe të Serbisë për zbatimin e marrëveshjes bazë për normalizimin e raporteve në mes të dy shteteve. Deri më 18 korrik ka mbetur që Kosova dhe Serbia t'i dërgojnë komentet e tyre lidhur me planin për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në këtë kontekst, Kosova është duke e kërkuar njohjen de-facto, ndërsa Serbia Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe

**PRISHTINË, 8 KORRIK** - Serbia e do Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, Kosova njohjen "de-facto". Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ka mbetur pa u zbatuar. Kryenegociatori Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç ishin në Bruksel javën e kaluar pasi paraprakisht shefat e tyre nuk kanë arritur ndonjë pajtim për zbatimin. Në këtë drejtim nga Prishtina dhe Beogradi priten ide për mënyrën e zbatimit të asaj për të cilën kryeministri Albin Kurti dhe presidenti Aleksandër Vuçiq ishin pajtuar vitin e kaluar. Kryenegociatori Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç deri vonë të martën e javës së kaluar kanë

qëndruar në Bruksel, ku kishin shkuar për gjetjen e një zgjidhjeje për mënyrën e zbatimit të marrëveshjes për rrugën e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Takimet e ndara me të dërguarin e Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak, e më pas takimi trepalësh, nuk rezultuan me arritjen e ndonjë pajtimi. Për rreth shtatë orë janë diskutuar një sërë çështjesh, ndërsa Lajçaku ka thënë se janë pajtuar "për një numër të hapave të ardhshëm". Deri më 18 korrik ka mbetur që Kosova dhe Serbia t'i dërgojnë komentet e tyre lidhur me planin për zbatimin e marrëveshjes bazike, siç ka thënë

zëvendëskryeministri Besnik Bislimi atë natë. Ai ka thënë se në bazë të komenteve që do të dërgohen prej të dyja palëve, ndërmjetësit evropianë do ta nxjerrin një propozim të ri për zbatimin e marrëveshjes. Bislimi ka thënë se pala serbe ishte e interesuar të diskutonte vetëm për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Kryenegociatori serb Petkoviç ka thënë se ka këmbëngulur në atë çështje meqë, sipas tij, është "thelbësore për mbijetesën e serbëve dhe procesin e normalizimit".

Takimit të kryenegociatorëve i kishte paraprirë një udhëtim i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel. Më 26 qershor ata u rikthyen në kryeqendrën evropiane. Por pavarësisht se BE paralajmëroi se ata do të merrnin pjesë në takime të ndara me shefin e diplomacisë evropiane, Josep Borrell, pasuar nga një takim trepalësh, kjo e dyta nuk ndodhi.

BE-ja ka organizuar takime me Kurtin dhe Vuçiqin për të analizuar dialogun dhe për

"rrugën përpara". Por, Kurti dhe Vuçiqi nuk janë ulur përballë njëri-tjetrit për të diskutuar për mënyrën e zbatimit të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve të arritur më 27 shkurt 2023 dhe për aneksin e zbatimit të saj të 18 marsit 2023, raporton "GE". "Si zakonisht, diskutimet ishin të vështira dhe në fund nuk pati takim trepalësh. Kosova nuk ishte e gatshme për një takim të tillë, Serbia ishte", kishte thënë Borrelli pas takimeve me të dy liderët.

Spanjoli, tashmë në fund të mandatit si shef i politikës së jashtme të BE-së, ua ka treguar gazetarëve tri kushtet që ka thënë se i kishte paraqitur Kurti për angazhimin e mëtejshëm në procesin e zbatimit të marrëveshjes për rrugën e normalizimit: "Së pari, zyrtarizimin e marrëveshjes themelore përmes nënshkrimit nga udhëheqësit e shteteve dhe qeverive përkatëse. Së dyti, tërheqjen e letrës së paraqitur zyrtarisht në BE nga ish-kryeministrja Bërnabiq, e datës 13 dhjetor 2023. Dhe, së treti, dorëzimin e Milan Radojçiqit dhe grupit të tij paraushtarak-

terrorist tek autoritetet gjyqësore të Kosovës".

Pa shqiptuar ndonjë vërejtje për asnjërën palë, Borrelli ka treguar se Serbia "nuk ishte e gatshme t'i përmbushte plotësisht kushtet e Kosovës, duke përmendur kufizimet kushtetuese". Ai ka thënë se Vuçiqi është deklaruar i gatshëm që "t'i shqyrtojë opsionet në lidhje me letrën e ish-kryeministres dhe zyrtarizimin e marrëveshjes në përputhje me praktikën e kaluar të dialogut për ta zhblokuar zbatimin e saj".

Udhëtimit të Kurtit e Vuçiqit në Bruksel i ka paraprirë një vizitë e Lajçakut në Prishtinë e Beograd, ku ka thënë se kishte ardhur për "mënyrën e ripërqendrimit në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe çfarë hapash konkretë do të ndërmarrim".

Megjithëse mandati i rregullt i tij përfundon në fund të gushtit dhe nga 1 shtatori do të duhej ta niste punën si ambasador në Zvicër, është vendosur që Lajçaku të qëndrojë në këtë detyrë deri në janar të vitit 2025. Ai ka thënë se ka ende punë për të bërë.

## Kosova dhe Vanuatusi nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

**PORT VILA, 8 KORRIK** - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti dhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme të Vanuatus, Matai Seremaiah, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes të dy ministrive. Gjatë takimit, zëvendësministri Ahmeti dhe zëvendëskryeministri Seremaiah kanë

vlerësuar lart marrëdhëniet në mes të dy vendeve dhe kanë diskutuar mbi mundësitë e fuqizimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe koordinimin shumëpalësh.

Po ashtu, palët kanë diskutuar për zhvillimet e fundit në rajonet e tyre dhe zhvillimet botërore. Të dyja palët kanë theksuar se paqja dhe stabiliteti janë në fokus të të dyja vendeve dhe janë pajtuar

t'i ndajnë të njëjtat vlera në këtë drejtim.

Pas takimit, palët kanë nënshkruar memorandumin për bashkëpunim midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Tregtisë së Jashtme të Republikës së Vanuatus.



# 'S'ka as çarçafë', kimioterapi në sallë të improvizuar të Hematologjisë

PRISHTINË, 8 KORRIK - Pacientët me kancer në Klinikën e Hematologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës përballen me kushte të rënda në sallën e improvizuar të kimioterapisë. Shumë prej tyre trajtohen edhe në një korridor të errët pranë, pa dritare, që kundërmon erë nga tualeti. "Dera nuk mbyllet... Djali im duhet të rrijë aty kur unë hyj në tualet", ka thënë Serie Plakolli, e sëmurë nga kanceri në gjak. Në ditët kur trajtohet me kimioterapi thotë se i duhet të qëndrojë aty së paku katër orë - nganjëherë edhe më gjatë. "Nuk ka kondicioner, as çarçafë për dyshekët", ka thënë ajo për "Radion Evropa e Lirë".

Në mungesë të hapësirave në Hematologji, pacientët me kancer janë zhvendosur në katin përdhës të ndërtesës, përkatësisht në sallë të destinuar për ushtrime dhe

ligjërata të studentëve.

Vetëm ata që duhet të marrin kimioterapi më gjatë se disa orë në ditë, shtrihen në repartin e klinikës.

Aty ku jepet terapia ditore janë 12 shtretër. "Tash për tash jemi këtu. E dimë që ka mungesa të shumta, por këto janë kushtet tona. Tash ka nisur ndërtimi i objektit të ri të klinikës dhe derisa të kryhet, do të jemi këtu", ka thënë ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së Klinikës së Hematologjisë, Suzana Krasniqi për "REL".

Në muajin maj, në oborrin e QKUK-së është vënë gurthemeli i Klinikës së Hematologjisë dhe Nefrologjisë.

Se kur do të përfundojë, nuk është e qartë. "REL"-i ka kontaktuar Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës për këtë temë, por udhëheqës të tij nuk ishin të

qasshëm.

Sipas një përshkrimi nga Klinika Mayo në ShBA, kimioterapia mund të shkaktojë edhe efekte të konsiderueshme anësore dhe jepet kryesisht në njësi kimioterapie ambulatorë.

Situata në Hematologji në QKUK është kështu me muaj të tërë. Në pesë të fundit e përjetoj edhe Y. M. Kjo grua nga Prizreni është duke u trajtuar për një lloj të kancerit në gjak dhe gati çdo javë i duhet të udhëtojë afro 90 kilometra për të arritur në Prishtinë. Të gjithë pacientët që kanë nevojë për kimioterapi referohen në QKUK, pasi është i vetmi institucion shëndetësor në Kosovë që e ofron këtë shërbim. "Të gjithë mbiemrat që janë më të këqij, mund t'i përdorësh për kushtet këtu (në Hematologji). Është tmerr. Nuk ka ajër të pastër, nuk ka kondicioner. Temperaturat janë

të larta, e shpesh duhet të qëndrojësh pesë orë", ka thënë ajo. Në ditën kur ekipi i "REL"-it, ka vizituar këtë klinikë, javën e fundit të qershorit, pa se disa pacientë merrnin kimioterapi edhe ulur në karrige, për shkak të mungesës së shtretërve të lirë.

Arsim Podrimja nga Drenasi, rreth 40 kilometra larg Prishtinës, kishte sjellë atë ditë në spital nënën tij, për të marrë dozën e gjashtë të kimioterapisë kundër kancerit. Ai ka thënë se përveç kushteve të rënda, edhe pritjet janë shumë të gjata. "Në orën 7:30 kemi ardhur këtu e deri në 9:30 nuk kanë nisur t'ia japin terapinë. Por, duhet ta zëmë vendin. Para orës 14:30 nuk do të mund të dalim nga këtu", ka thënë ai.

Pavarësisht vështirësive, shërbimet janë duke vazhduar. "Jemi në shërbim të pacientëve

aq sa kemi mundësi", ka thënë ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së Hematologjisë, Suzana Krasniqi.

Sipas të dhënave të kësaj klinike, vetëm në vitin e kaluar janë regjistruar 203 raste të reja me kancer. Mesatarisht në muaj, shërbime marrin mbi 270 pacientë.

Në maj të këtij viti është përfunduar rinovimi i Klinikës së Onkologjisë, ku trajtohen vetëm pacientë me lloje të ndryshme të kancerit.

Por, me vetëm 60 shtretër, edhe aty ka shpesh pritje të gjata. Me sfidat e pritjes përballen edhe pacientët të klinikave të tjera të QKUK-së, ashtu si edhe me kushte të rënda. "Nuk kemi se çka të bëjmë ne si staf. Ne e japim maksimumin për t'i ndihmuar pacientët", ka thënë një infermiere në Hematologji, e cila kujdeset për rreth dhjetë pacientë në ditë.



## Nënshkruhet marrëveshja e kontrollit të përbashkët kufitar Kosovë - Shqipëri

GJAKOVË, 8 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe homologu i tij nga Shqipëria, Taulant Balla, kanë nënshkruar të hënën në Qafë-Morinë të Gjakovës marrëveshjen e kontrollit të përbashkët kufitar.

Nënshkrimi i protokollit për zbatim të kontrollit të

përbashkët është bërë në prani të organeve policore të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Dy ministrat kanë thënë se pas këtij akti zyrtar ndërshtetëror do të krijohen rrethana lehtësuese për banorët e dy shteteve, në veçanti për pikat kufitare Qafë-Morinë, Qafë-Prush, Krushevë, Gllboçicë dhe Orçush.



## Policia në Pejë u bënë thirrje qytetarëve ta shmangin ndezjen e zjarreve

**PEJË, 8 KORRIK** - Policia në Pejë u ka bërë thirrje qytetarëve ta shmangin ndezjen e zjarreve për shkak të temperaturave të larta. Gjithashtu, policia u ka bërë thirrje qytetarëve të raportojnë apo lajmërojnë autoritetet për çdo person të dyshuar që mund të jetë i përfshirë në raste të tilla të zjarrvënieve. “Duke iu referuar temperaturave të larta gjatë këtyre ditëve dhe përvojave nga vitet e kaluara, zjarret shkaktojnë rrezikim të

përgjithshëm dhe pasoja të rënda kudo që shfaqen. Policia e Kosovës kërkon nga të gjithë qytetarët të jenë të kujdesshëm, ta shmangin ndezjen e zjarreve dhe të raportojnë apo lajmërojnë autoritetet për çdo person të dyshuar që mund të jetë i përfshirë në raste të tilla të zjarrvënieve. Policia e Kosovës do të ndërmarrë masa ligjore ndaj të gjithë atyre individëve që në një formë apo tjetër rrezikojnë jetën apo pronën e

qytetarëve, qoftë qëllimisht apo përmes pakujdesisë së shfaqur në çfarëdo forme. Apelojmë të të gjithë qytetarët të cilët frekuentojnë zonat malore të rajonit të Pejës, e në veçanti Bjeshkët e Nemuna që maksimalisht të jenë të kujdesshëm dhe të përmbahen çdo aktivitet që mund të shkaktoj zjarre gjatë përdorimit si (shkrepëse, cigare, grilla, zjarre në natyrë etj)”, është thënë në apelin e policisë.



## Pas dallavereve në konkursin për gradimin e policëve, IPK-ja publikon raportin e inspektimit

**PRISHTINË, 8 KORRIK** - Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka publikuar raportin e inspektimit të jashtëzakonshëm lidhur me menaxhimin e procesit të gradimit për rreshterë pas shqetësimeve të ngritura mbi rregullsinë e këtij procesi.

Raporti i IPK-së ka theksuar se procesi i gradimit është shoqëruar me disa dobësi në fazën e konkurimit, duke ngritur shumë shqetësime dhe ankesa.

IPK-ja ka nënvizuar nevojën për rishikimin e bazës ligjore aktuale për ta harmonizuar udhëzimin dhe programin e trajnimit themelor, si dhe për respektimin e kritereve të aplikimit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i raportit është përfshirja e kriterit etnik gjatë krijimit të paneleve vlerësuese, duke marrë parasysh pjesëmarrjen e kandidatëve nga etnitë e tjera. Edhe pse mbarëvajtja e testimit nuk evidentoi ndonjë dobësi të madhe, raporti thekson nevojën për përgatitje më cilësore të procesit nga ana teknike.

“Procesi i gradimit është përcjell me disa dobësi në fazën e konkurimit si rezultat i të cilave janë ngritur shumë shqetësime dhe ankesa lidhur me këtë fazë. Vihet në pah nevoja e rishikimit të bazës ligjore aktuale, duke marrë parasysh nevojën e harmonizimit të Udhëzimit dhe Programit të trajnimit themelor, si dhe respektimit të kritereve të aplikimit. Respektimi i kriterit etnik gjatë krijimit të paneleve vlerësuese duhet të merret parasysh varësisht prej proceseve të gradimit dhe pjesëmarrjes së kandidatëve nga etnitë e tjera. Mbarëvajtja e testimit nuk ka evidentuar ndonjë dobësi



përveç nevojës për përgatitje më cilësore të procesit sa i përket aspektit teknik”, është thënë në raportin e IPK-së.

IPK-ja ka dhënë tetë rekomandime kryesore për Policinë e Kosovës: “IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të rishikojë harmonizimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 për Procedurën e Gradimit për Zyrtarët Policor, me periudhën e realizimit të trajnimit themelor, duke qartësuar edhe rrugëtimin e personelit nga grada ‘kadet’ deri në gradën ‘polic i lartë’. IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës që në të ardhmen gjatë përgatitjes së shpalljeve të konkurseve për këtë

gradë, të përfshijë edhe kohën e qëndrimit minimal në gradë në mesin e kritereve të aplikimit, drejt respektimit të plotë të kërkesave të udhëzimit. IPK-ja i rekomandon drejtorit të Divizionit të Personelit dhe Administratës që të përkujdeset në aspektin administrativ për kalimin me kohë të zyrtarëve policor nga grada kadet deri në gradën polic i lartë, duke respektuar afatet e parapara me udhëzim. IPK-ja i rekomandon drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që të sigurohet se sistemi PRIMS aplikon masat kufizuese për filtrimin e aplikimeve që nuk plotësojnë kriteret për t’iu nënshtruar proceseve të gradimit. Në raste kur aplikimet kryhen në

mënyrë fizike, të sigurohet se ndiqen rregullat e aplikimit, përfshirë dhe shqyrtimin dhe verifikimin e historikut disiplinor dhe penal të kandidatëve. IPK-ja i rekomandon drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që të sigurohet se në proceset e gradimit respektohet parimi i përfshirjes në panele edhe të anëtarëve nga radhët e komuniteteve të tjera etnike. IPK i rekomandon Kryesuesit të Komisionit të procesit të gradimit dhe drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës që në të ardhmen të sigurohen që kandidatët gjatë aplikimit të kenë të kryer vlerësimin e performancës, si një nga pikat e vlerësimit brenda procesit të


gradimit. IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Kryesuesit të Komisionit të procesit të gradimit që të sigurohet se anëtarët e paneleve vlerësuese kuptojnë detyrat lidhur me procesin e testimit me shkrim, si dhe kanë njohuri të nevojshme për plotësimin e evidencave lidhur me materialet e testimit (formularët). IPK-ja i rekomandon drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të ndërmanrë veprime për të evituar çfarëdo dobësie apo lëshimi në këtë proces të gradimit, duke e konsideruar këtë raport si pasqyrues të gjetjeve që mund të kenë dëmtoar kredibilitetin e mbarëvajtjes së procesit në fjalë”, është thënë në raportin e IPK-së.

## Arrestohet një i dyshuar për tri vepra penale në Prizren

**PRIZREN, 8 KORRIK** - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar një person të dyshuar veprën penale “Lëndim i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 5 “Mosdhënia e ndihmës”, neni 188, paragrafi 4 si dhe “Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre” neni 378, paragrafi 1, pika 13. Njësitë e Hetimeve Rajonale të Policisë në Prizren ka bërë me dije se përmes rrugëve

operative ka arritur ta arrestojë të dyshuarin H. B. “Arrestimi i tij është bërë me dyshimin se i njëjtit ka qenë i përfshirë në një rast ‘Lëndim i rëndë trupor’, nga neni 186, paragrafi 5, ‘Mosdhënia e ndihmës’, neni 188, paragrafi 4, si dhe ‘Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre’, neni 378, paragrafi 1, pika 1.3, i cili ka ndodhur më 06.07.2024 në lagjen

‘Bazhderana’ në Prizren. I dyshuari është shoqëruar në SRH-Prizren, u në prani të avokatit mbrojtës është intervistuar”, ka njoftuar Policia e Kosovës. Sipas njoftimit, i dyshuari ka qenë në dijeni për veprën penale si dhe kryerësin e veprës penale, por nuk e ka lajmëruar rastin si dhe kryesin e saj, as nuk i ka ofruar ndihmë viktimës.



# Lansohet fushata 'Festo me zemër, jo me armë!'

PRISHTINË, 8 KORRIK - "Përdorimi i paligjshëm i armëve janë shkaktarët kryesorë të vrasjeve në Kosovë". Kështu është thënë të hënën në lansimin e fushatës "Festo me zemër, jo me armë" nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Aty është thënë se kjo dukuri është në rënie, por prapë mbetet kërcënim për rendin dhe sigurinë publike.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, ka thënë se Policia e Kosovës konfiskon përafërsisht 1 500 armë ilegale të llojeve të ndryshme për çdo vit. Gashani ka deklaruar se misioni i tyre mbetet avancimi i nivelit të sigurisë në vend. Sipas tij, statistikave tregojnë që armët pa leje janë shkaktarë të vrasjeve. "Statistikave tregojnë që armët pa leje, që janë në përdorim të paligjshëm nga qytetarët, janë shkaktarë të vrasjeve. Edhe pse zotërimi i paligjshëm i armëve të zjarrit dhe armëve të ftohta është në rënie çdo vit, kjo dukuri ende mbetet kërcënim për rendin dhe sigurinë publike në Kosovë dhe shqetësim për institucionet e sigurisë. Policia e Kosovës çdo vit konfiskon përafërsisht 1 500 armë ilegale të llojeve të ndryshme. Konfiskimi i armëve të vogla dhe të lehta po vazhdon, por edhe municionet e kalibrave të ndryshëm. Sot MPB-ja po bën hapjen zyrtare të kampanjës vetëdijësuese 'Festo me zemër, jo me armë'. Le të kujtohet festa e jo vrasja apo lëndimi. Lidhur me parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duhet bashkëpunim reciprok në mes të

qytetarëve dhe organeve të zbatimit të ligjit për parandalimin e gjuajtjeve me armë dhe në përgjithësi krijimi i një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e republikës", ka thënë Gashani.

Ndërsa përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, Annemarie Douwes, ka thënë se unioni në Kosovë mbetet i përkushtuar për mbështetjen e këtyre fushatave që kanë për qëllim promovimin e ndërgjegjësimit. "BE në Kosovë mbetet e përkushtuar për mbështetjen dhe brengjen që kanë për qëllim promovimin e fushatave të ndërgjegjësimit si dhe veprimeve parandaluese për zvogëlimin e ndikimit negativ të të shtënave festive", ka thënë Douwes.

Ndërsa përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, Arbnesh Ajvazi, ka deklaruar se brenda vitit arrijnë të konfiskojnë mbi 1 500 armë ilegale dhe mbi 20 mijë municione të ndryshme. Ai ka thënë se vitin e kaluar është vërejtur një rënie e lehtë e përdorimit të armëve ilegale. "Parandalimi i përdorimit të armëve gjatë festave paraqet një sfidë të madhe për ne si shoqëri. Kultura dhe traditat tona shpeshherë kanë përdorimin e armëve si pjesë e festimeve, por duhet ta ndryshojmë këtë mentalitet. Pjesa më e madhe e armëve që përdoren në vend, përfshirë ato në festa, janë të zotëruara në mënyrë ilegale. Pjesa më e madhe janë të jashtëligjshme, andaj kjo duhet të parandalohet. PK ka punuar shumë për t'i mbrojtur shtetasit e saj dhe për të ofruar siguri, duke



konfiskuar armë ilegale. Brenda vitit konfiskojmë 1 200 deri në 1 500 armë dhe mbi 20 mijë municione të ndryshme", ka thënë Ajvazi, duke shpalosur edhe disa statistika të përdorimit të armëve ndër vite nëpër ahengje. "Në vitin 2023 kemi më pak raste. Në vitin 2022 kemi pasur 155 armë të sekuestruara vetëm në ahengje, që kanë qenë të përdorura në ahengje, ndërsa në vitin 2023 kemi 107 raste. Rastet që janë raportuar për të shtëna me armë, qershor-gusht 2023, kemi arritur t'i konfiskojmë në muajin qershor 47 armë. Këto nuk kanë qenë armë që janë përdorur, por i kanë poseduar të pranishmit. Në korrik kemi konfiskuar 24 armë dhe në qershor 54 armë", ka thënë Ajvazi.

## Gërvalla: Arma s'është mjet për festë, as nuk simbolizon gëzim

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka thënë të hënën, në lansimin e fushatës ndërgjegjësuase "Festo me zemër, jo me armë", se përdorimi i armëve të zjarrit është një problem që prek shumë shoqëri. Ajo është shprehur se arma nuk është mjet për festë as nuk simbolizon gëzim por, sipas saj, është e rrezikshme dhe sjell vetëm hidhërim. "Përdorimi i armëve të zjarrit është një problem që prek shumë shoqëri, jo vetëm tonën. Arma nuk është mjet për festë. Arma nuk simbolizon gëzim. Ajo është e rrezikshme dhe sjell vetëm

hidhërim", ka thënë Gërvalla. Gërvalla ka folur edhe për Policinë e Kosovës, duke thënë se është një nga më të suksesshmet dhe profesionalet jo vetëm në rajonin tonë, por edhe në kontinentin evropian. "Policia e Kosovës është një nga policitë më të suksesshme dhe profesionale jo vetëm në rajonin tonë, por edhe në kontinentin evropian, prandaj qytetarët kanë besim të plotë në të. Akti i fundit i agresionit në Banjskë, shtimi i sigurisë në veri, luftimi i kimit dhe korrupsionit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe lufta e suksesshme kundër narkotikëve dhe bandave kriminale, janë dëshmi të qarta të përkushtimit dhe profesionalizimit të policisë sonë", ka thënë Gërvalla.

# Haxhiu kundërshton raportin e IKD-së për vlerësimin e performancës së anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka mohuar kategorikisht raportin e publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) sa i përket performancës së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës në raport me Ministrinë e Drejtësisë. Sipas saj, pretendimet në këtë raport nuk qëndrojnë dhe se për këtë kanë pasur përpjekje për bashkëpunim dhe angazhim me KPK-në, KGJK-në dhe me shoqërinë civile. "Mendoj që nuk qëndrojnë. Është e vërtetë që për disa reforma ne kemi pasur mungesë të bashkëpunimit, për faktin se ju e dini që tashmë ka qëndrime publike. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial nuk i kanë mbështetur amendamentet kushtetuese për vettingun, megjithatë ato janë në Kuvendin e Kosovës dhe për faktin që ata nuk kanë pasur mbështetje për këto procese, natyrisht se pastaj ka pasur edhe deklarata publike për të njëjtat", ka thënë Haxhiu, duke shtuar se kanë bërë përpjekje maksimale për bashkëpunim. "Duket që nuk



i kanë informacionet e duhura, por ne kemi pasur përpjekje maksimale që të angazhohemi, që të kemi bashkëpunim edhe me shoqërinë civile. Madje Ministria e Drejtësisë gjatë gjithë kësaj kohe ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me organizatat e shoqërisë civile, po ashtu me të gjithë partnerët e

tjerë. Kanë dërguar komente, i kemi marrë parasysh disa, disa për shkak të qëndrimeve ndryshe të shumicës së anëtarëve nuk kanë ecur tutje, megjithatë ne jemi duke bërë përpjekje maksimale që sa më parë t'i dërgojmë këto ligje në Kuvend të Kosovës. Por, para se t'i dërgojmë ato, na duhen edhe disa

konsultime me Këshillin Gjyqësor, pastaj do t'i publikojmë edhe për opinionin publik dhe për anëtarë të tjerë të grupit punues dhe do të ecim tutje", ka thënë Haxhiu. Në lidhje me reformën në drejtësi që ka të bëjë me Këshillin Prokurorial, ministria Haxhiu ka thënë se nuk mund të veprojnë

në bazë të asaj që dëshirojnë disa persona të caktuar. "Sa i përket reformës në Këshillin Prokurorial, Këshilli Prokurorial e ka kundërshtuar reformën në Këshillin Prokurorial, por ne nuk veprojmë në bazë të tekeve të individëve. Ne kemi dhënë zotime para qytetarëve dhe kemi qenë të obliguar t'i shtyjme përpara, prandaj edhe si ministre e Drejtësisë gjatë gjithë mandatit tim jam përpjekur që reformat që i kemi premtuar para qytetarëve t'i përmbushim", ka thënë Haxhiu për "Ekonomia Online". IKD-ja në një konferencë për medie të hënën ka paraqitur raportin me vlerësimin e performancës së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, ku u tha se nuk mund të bëhet nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës.

Drejtori ekzekutiv i këtij Instituti, Ehat Miftaraj, ka thënë se Ministria e Drejtësisë, fatkeqësisht, nuk po vepron në mënyrë ligjore për t'i përmbushur kërkesat për një proces transparent.

## Paguhet 275 euro, punëtorët teknikë të Kuvendit paralajmërojnë grevë nëse nuk u rriten pagat

PRISHTINË, 8 KORRIK - Punëtorët teknikë në Kuvendin e Kosovës kanë paralajmëruar veprime sindikale në rast se nuk merret parasysh kërkesa e tyre për rritje të pagave. Kjo është bërë me dije nga kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi. Në shkresën që Azemi ua ka

drejtuar grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës është thënë se punëtorët teknikë marrin pagë prej 275 eurosh. “Ne punëtorët teknikë në Parlamentin e Kosovës, që juve ju krijojmë kushte për punë të përditshme, ose ankohuni në punën tonë, ose na mbështetni në kërkesën për rritje të pagave

tona sepse nga java e ardhshme ne nuk do t’ju ofrojmë shërbimet tona me pagat që i marrim nga 275 euro. Nga e marta (sot) fillojmë veprimet tona sindikale konform ligjit mbi grevat, andaj nëse doni reagoni, është edhe në interesin tuaj”, është thënë në shkresën drejtuar grupeve parlamentare.



## Auditori gjen parregullsi në një tender të KOSTT-it



PRISHTINË, 8 KORRIK - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka evidentuar disa parregullsi në Ndërmarrjen Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), veçanërisht ka gjetur dobësi në vlerësimin e tenderëve. Sipas auditorit, më 30 tetor 2022 ndërmarrja kishte publikuar dosjen e tenderit për projektin “Furnizim me pajisje mbrojtëse për nënstacione”. Në këtë procedurë kishin dorëzuar ofertë dy operatorë ekonomikë. ZKA-ja ka bërë me dije se fillimisht ndërmarrja kishte eliminuar operatorin ekonomik (OE) me çmimin më të lirë për shkak të mospërmbushjes së specifikave teknike dhe kishte shpallur fitues operatorin e dytë

ekonomik me çmimin më të lirë. Sipas raportit, pas ankesës nga operatori i eliminuar, ndërmarrja kishte kthyer procesin në rivlerësim e pas këtij procesi ishte aprovuar ankesa e operatorit të eliminuar. Ndërsa operatori ekonomik, i cili fillimisht ishte shpallur fitues, pas rivlerësimit ishte shpallur i papërgjegjshëm për shkak të mospërmbushjes së një specifikave teknike që nuk ishte pjesë e ankesës. “Kontrata ishte nënshkruar me datë 01.01.2023 me operatorin që kishte parashtruar ankesë në vlerë 23,936 euro. Pas analizimit të dokumenteve të regjistrimit të biznesit dhe verifikimit të tyre në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës, të dy operatorët që kishin ofertuar në

këtë proces tenderues kishin të njëjtin pronar të biznesit. Si rrjedhojë, ndërmarrja në këtë rast do të duhej të bëjë anulimin e procedurës së tenderit në harmoni me kërkesat ligjore”, është thënë në raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore për KOSTT-in. Më tutje është thënë se nënshkrimi i kontratës në këtë rast kishte ndodhur për shkak të mosverifikimeve të duhura nga personat përgjegjës të prokurimit të kërkesave të përshtatshme profesionale. Për këtë çështje, ZKA-ja i ka rekomanduar bordit të drejtorëve të KOSTT-it që të përkujdeset për zbatimin e parimeve të konkurrencës. “Duhet të siguroj që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave

dhe procesit të nënshkrimit të kontratave Departamenti i Prokurimit kujdeset që janë zbatuar parimet e konkurrencës së mirëfilltë dhe se me kontratë shpërblehen vetëm operatorët e përgjegjshëm”, është thënë në rekomandimin e ZKA-së. ZKA-ja në KOSTT ka vërejtur edhe tejkalim të vlerës totale të kategorisë të kontrata publike kornizë “Servisim dhe mirëmbajtja e kamionëve me krana”. Sipas ZKA-së, çmimi për njësi i peshuar sipas kategorisë së nënshkruar më 25 nëntor në kohëzgjatje prej 36 muajsh është vërejtur që për shërbimet e kryera ishte tejkaluar vlera totale e kategorisë e cila është përcaktuar në bazë të rëndësisë së shërbimit në kategori. “Vlera e tejkaluar për kategorinë dy është

23 000 euro dhe kategorinë katër është 10 000 euro. Kjo kishte ndodhur për shkak të poentimit jo të duhur të kategorive përkatëse si dhe nga kujdesi jo i duhur në respektimin dhe interpretimin e kërkesave ligjore”, është thënë në raportin e ZKA-së. Për këtë, ZKA-ja i ka rekomanduar bordit të drejtorëve të KOSTT-it të sigurojë që janë forcuar kontrollet në mënyrë që pagesat për shërbimet e kryera nuk tejkalojnë vlerën totale të kategorisë e cila është përcaktuar në bazë të rëndësisë së shërbimit në kategori. Raporti i ZKA-së për KOSTT-in ka rezultuar me 10 rekomandime, prej tyre tetë rekomandime të reja dhe dy rekomandime të përsëritura.

## Shkyçen nga shërbimi i ujit konsumatorët me borxh 500 deri në 3 mijë euro

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kompania Regjionale e Ujësjellësit (KRU) Prishtina ka shkyçur nga shërbimet e furnizimit me ujë të

pijshëm në Prishtinë dhe rrethinë konsumatorët me borxhe 500 deri në 3 mijë. “Shkyçen nga shërbimet e furnizimit me ujë të

pijshëm në Prishtinë dhe rrethinë, konsumatorë me borxhe prej 500-3000 euro, amvisëri e biznese”, ka njoftuar KRU Prishtina.

Sipas këtij njoftimi, nuk do të ketë ujë për ata konsumatorë që nuk i kryejnë obligimet e tyre për shërbime të ujit.





# Sa shumë pikëpyetje. Çfarë do ndodhë tani në Francë?

Çfarë do të ndodhë tani? Sipas Kushtetutës franceze, kreu i shtetit është i vetmi që vendos kur bëhet fjalë për emërimin e kryeministrit dhe këtë mund ta bëjë kur të dojë, nuk ka afat. Çështja është të zgjidhet një kryeministër që është shprehje e mazhorancës, përndryshe qeveria mund të rrezohet menjëherë me mocion mosbesimi. Por Asambleja Kombëtare tani është e paqeverisshme, me tre blloqe kryesore – Fronti i Ri Popullor fitimtar i krahut të majtë, blloku i Ansamblit Macronist që çuditërisht mbajti fort të dielën, dhe blloku kombëtar Rassemblement i cili doli i treti – që kanë mbetur shumë larg shumicës absolute.

Skenari i parë që hapet përpara Emmanuel Macron, por jo i vetmi, është ai i një qeverie të mbështetur nga një koalicion forcash të largëta mes tyre, dhe që ishin përballur me njëra-tjetrën gjatë fushatës elektorale. Edhe shumica e epokës së Macron nga viti 2017 e deri më sot ishin koalicione, në fund të fundit, midis partisë së Macron dhe asaj të François Bayrou për shembull, por që u paraqitën si të tilla që para zgjedhjeve. Ndërsa tani, do të bëhet fjalë për gjetjen e një marrëveshjeje mes forcave që deri dje ishin konkurrense dhe që do të duhet të heqin dorë nga një pjesë e programeve dhe premtimeve të

tyre elektorale, për të gjetur një marrëveshje që mundëson qeverisjen e vendit. Një praktikë e zakonshme në Gjermani, me negociata disa-mujore që pas zgjedhjeve çojnë në një qeveri koalicioni të thirrur për të zbatuar një program qeveritar të shkruar dhe të kundërfirmosur. Një përvojë krejtësisht e re në Francë, por e kërkuar nga shumë njerëz. Mbetet për t'u parë, kush mund të marrë pjesë?

Jean-Luc Mélenchon ka deklaruar tashmë solemnisht, se nuk dëshiron asnjë marrëveshje nën tryezë me makronistët, sepse NFP-ja e tij fitoi duke u bërë grupi i parë dhe për këtë arsye ka të drejtën të qeverisë. Megjithatë, ai nuk i ka numrat për ta bërë këtë, dhe një qeveri NFP do të rrezohet në votimin e parë në parlament. Por mbi të gjitha, nuk është puna se Mélenchon nuk dëshiron të krijojë aleanca. Më shumë janë të gjithë të tjerët që nuk duan të krijojnë aleanca me të. Edhe ata që e bënë këtë deri dje, për shembull e majta e moderuar e socialistëve të Olivier Faure dhe Place République e Raphael Glucksmann. Ky i fundit, veçanërisht, deri në Kampionatin Evropian ishte armiku më i deklaruar i Mélenchon, rivali i tij në gjithçka. Nëse Glucksmann pranoi të ishte pjesë e NFP, pavarësisht pranisë së Mélenchon, të cilin ai e urren dhe



pavarësisht nga sulmet në kufijtë e antisemitizmit të militantëve të tij, e bën “vetëm – dhe ai e ka thënë disa herë – për të ndaluar RN. Ky ishte prioriteti deri më 7 korrik. Nga e hëna e 8 korrikut, në

mëngjes hyjmë në një botë tjetër, lojërat ndryshojnë”. Kjo do të thotë, që Glucksmann mund të shpërbente menjëherë, kartelin elektoral të formuar pa dëshirë me Mélenchon dhe të

vihej në dispozicion për aleanca të tjera, këtë herë ato reale politike, me forca të tjera demokratike, pro-evropiane, pro-ukrainase të pranishme në Parlament.

## Gëzimi i kombëtares: Faleminderit Francë

Lehtësimi është i barabartë me shqetësimin që kishin ndërjet gjatë javëve të fundit. Është e jashtëzakonshme – shkroi Jules Koundé, mbrojtësi i kombëtares franceze të futbollit e cila ka arritur në gjysmëfinalen e Euro 2024. Urime të gjithë francezëve që janë mobilizuar për të siguruar që ky vend i bukur që është Franca të mos e gjejë veten të qeverisur nga e djathta ekstreme”.

Dhe të mendosh se e diela e zgjedhjeve, në vendqëndrimin ku Franca po përgatit gjysmëfinalen ndaj Spanjës, nuk nisi me zgjedhjet si temë kryesore. Mes videove dhe analizave taktike u fol më së shumti për futbollin. Por në mbrëmje shfaqja e rezultateve të para i bëri të pashmangshme komentet dhe kënaqësinë. Nga lojtarët dhe stafi që mundën të votonin – një numër më i vogël se në raundin e parë, sepse në disa zona rezultati ishte tashmë përfundimtar – e bënë përsëri përmes instrumentit të delegimit (edhe në raundin e parë lojtarët votuan në një përqindje më të lartë se mesatarja, sado e lartë, e vendit). Gjatë konferencës për shtyp në stadiumin e Paderbornit, raporton Le Parisien, mesfushori i Monacos, Youssouf Fofana,



kishte shmangur për pak çaste kufizimin e heshtjes zgjedhore me një frazë të vetme: “Situata është shqetësuese”. Kështu doli edhe një herë se në kombëtaren

franceze të futbollit ekzistonte një grup, jo pakicë, i rreshtuar haptaz kundër të djathtës ekstreme të Rassemblement National. I udhëhequr pa

mëdyshje nga kampioni më i famshëm. Kylian Mbappé, sulmuesi i ri i Real Madridit, kishte shpresuar në TV live, para ndeshjes së 1/16-ave kundër

Portugalisë, “që Franca të mos përfundojë në duart e atyre atje”. Përgjigja nuk vonoi.

Kritikët më të pamëshirshëm të futbollit, duke aluduar për katër ndeshjet e tij të fundit sipas tyre të dobëta, argumentuan me sarkazëm se kapiteni i Les Bleus nuk ka zbritur ende në fushë në Kampionatin Evropian, por nga ana tjetër e ka bërë me dëshirë në fushatën elektorale. Dhe liderja e Rassemblement National Marine Le Pen ishte e ashpër në një intervistë për CNN: “Mbappé është një lojtar i madh, por francezëve u ka ardhur në majë të hundës duke marrë këshilla për votën nga aktorët, futbollistët dhe këngëtarët, miliarderë që jetojnë jashtë”. Disa sondazhe treguan se 52% e francezëve ishin kundër marrjes së një qëndrimi nga ana e ekipit.

“Shpresojmë që pas 7 korrikut të jemi ende krenarë që e veshim këtë fanellë”, kishte thënë numri 10 i Francës. Dhe tani mund të flitet ndoshta edhe për një efekt Mbappé në votime. Nëse sot në Mynih është ai që do të marrë pjesë në konferencën për shtyp para gjysmëfinalës me trajnerin Deschamps, vështirë se do të zgjedhë të jetë diplomatik. / bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Vushtrria paraqet Dallkun

**VUSHTRRI, 8 KORRIK** - FC Vushtrria ka bërë me dije se Armend Dallku është trajneri i tyre i ri. Përmes një njoftimi në "Facebook", klubi vushtrrias njoftoi se Dallku do t'i udhëheqë drejt rikthimit në Superligën e Kosovës, ndërsa kanë

paralajmëruar edhe befasi të tjera. "Jemi të lumtur të mirëpresim Armend Dallkun si trajnerin e ri të FC Vushtrrisë! Me një histori të jashtëzakonshme dhe një pasion për lojën, Dallku sjell një përvojë të pasur dhe një perspektivë të re për

klubin tonë. Dallku është i njohur për qasje strategjike ndaj lojës dhe fokus në zhvillimin e lojtarëve dhe punën në ekip. Jemi të emocionuar të fillojmë këtë kapitull të ri dhe jemi të sigurt se trajneri do të na udhëheqë drejt lartësive të

reja. Qëndroni të lidhur për më shumë përditësime dhe përgatituni për një sezon emocionues përpara!", thuhet në njoftimin e Vushtrrisë. Ish-lojtari i Kombëtares së Shqipërisë, Armend Dallku, ka punuar trajner në skuadrën e



Prishtinës dhe atë të Dukagjinit nga Klina.

# Sonte gjysmëfinalja e parë, Spanja e Franca kërkojnë finalen

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**MÜNCHEN, 8 KORRIK** - Spanja dhe Franca janë vetëm një hap larg finaleve së madhe të Kampionatit Evropian "Euro 2024", pasi sonte (e martë) përballen mes vete në kuadër të gjysmëfinaleve të parë. Spanja, duke u mburrur me një rekord të përsosur deri më tani, arriti në gjysmëfinale pasi e mposhti nikoqirin e këtij kampionati, Gjermaninë. Në anën tjetër Franca e mposhti pas penalltive Portugalinë. Sulmuesi i Francës, Antonio Griezmann, ka thënë para gjysmëfinaleve së spanjollët nuk i frikësohen asnjë kundërshtari. Ai ka lavdëruar dyshen Yamal - Williams, por beson se do të arrijnë t'i ndalin dhe të kualifikohen në finale. "Asnjë skuadër nuk na tremb. Duhet të kemi besim te vetja jonë, dhe të japim gjithçka në fushë për të arritur në finale, mungon vetëm një ndeshje për

ta bërë këtë. Është fantastike të arrish gjithnjë mes katër ekipeve më të mira. Spanja është një skuadër e madhe, me një trajner të ri që po bën mirë dhe me lojtarë të rinj si Yamal dhe Williams. Tani është radha jonë për t'i bërë keq në sulm dhe t'i bllokojmë këto lojtarë në mbrojtje", ka thënë Griezmann. Në çerekfinalen ku u përballën dy skuadrat ndër më të forta të turneut, fituese doli Spanja ndaj Gjermanisë, pasi realizoi në shtesë për 2-1 nëpërmjet Mikel Merino. Koha e rregull përfundoi 1-1 ku Dani Olmo ishte shënues për spanjollët, derisa për gjermanët barazoi Florian Wirtz. Spanja është e vetmja skuadër që i ka të gjitha fitoret deri më tash në këtë kampionat. Në anën tjetër, Franca, pasi e humbi vendin e parë në grup nga Austria, arriti në 16-të ta eliminojë Belgjikën dhe në çerekfinale e mposhti Portugalinë pas penalltive. Spanja në këtë ndeshje do të ketë



### FORMACIONET E MUNDSHME:

**Spanja:** Simon: Navas, Nacho, Laporte, Cucurella; Olmo, Rodri, Ruiz; Yamal, Morata, Williams.

**Franca:** Maignan; Kounde, Saliba, Upamecano, Hernandez; Kante, Tchouameni, Rabiot; Griezmann; Kolo Muani, Mbappe.

mungesën e dy mbrojtësve Dani Carvajal dhe Robin Le Normand

për shkak të pezullimeve, ndërsa Pedri u lëndua dhe do të jetë

mungesë e madhe. Navas, Nacho dhe Olmo pritet të jenë zëvendësuesit e tyre. Ndërkohë Franca nuk ka probleme me mungesa, përveç shqetësimit për Kylian Mbappe, i cili e ka të lënduar hundën. "Jam mirë dhe jam shumë i lumtur. Po rikuperohem dhe po përgatitem sa më mirë për ndeshjen e radhës. Finalja? Nuk është shumë larg. Jemi vetëm një hap larg, por fitorja nuk është e lehtë. Ndeshjet kundër Francës janë gjithmonë të komplikuar, por ne mund ta bëjmë këtë hap. Franca është një skuadër shumë e fortë, e cila arriti në gjysmëfinale për meritat e saj dhe pa asnjë surprizë. Ne e dimë mirë se çfarë mund të bëjnë lojtarët e saj. Ne duhet ta vlerësojmë cilësinë teknike individuale të sulmuesve të tyre, por duhet të fokusohemi te vetja. Jemi në një dinamikë shumë pozitive", ka thënë sulmuesi i Spanjës, Dano Olmo.

# Kosova e gatshme për Kompleksin Ndërkombëtar në Francë



**PRISHTINË, 8 KORRIK** - Delegacioni i Kosovës, i përbërë nga pesë lojtare, një trajner, një gjyqtar, sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, si dhe menaxherja e projekteve, Edita Medunjanin, janë nisur drejt Bordeaux në Francë ku do të marrin pjesë në kompleksin ndërkombëtar në kuadër të projektit PROMISE. Ky kompleks do t'i mbledhë përfaqësueset nga të gjitha shtetet partnere:

Bullgaria, Spanja, Franca, Irlanda dhe Portugalia. Gjatë këtij eventi pjesëmarrëset do ta kenë mundësinë të angazhohen në aktivitete të ndryshme, përfshirë ligjërata të mbajtura nga ekspertë të njohur, ndeshje konkurruese dhe vizita në eventin 3x3 Women's Series. Kompleksi ndërkombëtar është pjesë e projektit PROMISE, i cili ka për qëllim promovimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në basketboll në

të gjitha nivelet e përgjegjësisë. Ky projekt ndërkombëtar përfshin shtatë institucione nga gjashtë vende: Spanja, Irlanda, Kosova, Portugalia, Franca dhe Bullgaria. Federata e Basketbollit e Kosovës vazhdon të jetë e përkushtuar për mbështetjen dhe promovimin e basketbollit të femrave, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin profesional dhe personal të lojtareve, trajnerëve dhe gjyqtarëve.

## Shaqiri, afër rikthimit në Evropë

**ATHINË, 8 KORRIK** - Xherdan Shaqiri do të largohet nga Chicago pas dy vitesh e gjysmë. Futbollisti nga Zhegra e Gjilanit është prej futbollistëve më të paguar në

MLS të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por, një rikthim në kontinentin e vjetër është në horizont. Siç raportoi portali grek "SDNA" para disa ditësh, Panathinaikos është

shumë i interesuar për shërbimet e reprezentuesit zviceran. Klubi nga Athina e ka bërë Shaqirin objektivin kryesor. Xherdan Shaqiri nuk pati minuta të mjaftueshme

në "Euro 2024", megjithatë arriti të shënonte një gol ndaj Skocisë, goditi shtyllën dhe shënoi penalltinë ndaj Anglisë në ato pak minuta sa luajti.







# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me operatorin “Sharr Cem” Sh.p.k. Hani Elezit, fabrikë për prodhimin e çimentos organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 30.07.2024, në ora: 10:00, në hapësirat e LAB (Laboratori për Aktivitete të Biznesit), Rr. Adem Jashari, Nr. 218, 71510, Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga operatori “Sharr Cem” Sh.p.k. Hani Elezit, fabrikë për prodhimin e çimentos, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ermal Nuza shpall të humbura dëftesat e klasës dhjetë dhe njëmbëdhjetë të Gjimnazit “Ahmet Gashi” Prishtinë.
- Anton Gjogaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.
- Blinera Hertica nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -X-, të lëshuar nga Gjimnazi “Ahmet Gashi”, Prishtinë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# TRADITË QË NGA 1992

